



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.487/12 prot.

Datë 25.03.2026

V E N D I M

Nr. 423 /2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 25.03.2026, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.320/2026, datë 02.03.2026, për procedurën e prokurimit “*E Hapur*”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.

Ankimues: Operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK, Nipt. K71903025A, Adresa: Rr. Shyqyri Bërxolli, P. Inter Co-Sat, Seksioni B, Kati i 6, Nr. 6/5, Dera 28B, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Shkodër.
Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

I.1. Me Vendim Nr.320/2026, datë 02.03.2026, Komisioni i Prokurimit Publik vendosi:

- 1. Të pranohet pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Optima Communication” ShPK për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.*
- 2. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi, duke dokumentuar veprimet e kryera me publikimin e shtojcës në zbatim të Vendimit të KSHA-së dhe konstatimeve të këtij vendimi.*
- 3. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK.*
- 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
- 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën ardhur me nr.5252/1 prot., datë 11.03.2026, protokolluar me tonën nr. 487/8 prot., datë 13.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr.320/2026, datë 02.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit sipërcituar.

I.3. Me shkresën ardhur me shërbim postar me objekt: Kërkesë për sqarim dhe zbatim vendimi, protokolluar me tonën me nr. 451/8, date 10.03.2026, nga operatori ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK, drejtuar AK-së dhe për dijeni KPP-së, me objekt: Kundërshtim i veprimeve e AK-së dhe shtojcës së publikuar, mbi moszbatim të vendimit mbi modifikime të DST së.

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën ardhur me nr.5252/1 prot., datë 11.03.2026, protokolluar me tonën nr. 487/8 prot., datë 13.03.2026, me objekt “Zbatim Vendimi” autoriteti kontraktor informon, se ka zbatuar vendimin Nr.320/2026, datë 02.03.2026, të Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.2. Me shkresën ardhur me shërbim postar me objekt: Kërkesë për sqarim dhe zbatim vendimi, protokolluar me tonën me nr. 451/8, date 10.03.2026, nga operatori ekonomik ankimues “Optima Communication” ShPK, drejtuar AK-së dhe për dijeni KPP-së, me objekt: Kundërshtim i veprimeve e AK-së dhe shtojcës së publikuar, mbi moszbatim të vendimit mbi modifikime të DST së.

Referuar shkresave të mësipërme, Komisionit të Prokurimit Publik kreu verifikime në Sistemin e Prokurimeve Elektronike në lidhje me procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi dhe konstatoi se, autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcë për modifikimin e dokumentave të tenderit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Referuar vendimit të KPP-së si edhe përmbajtjes së shtojcës së publikuar në SPE, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet dhe konstatoi, se autoriteti kontraktor në shtojcën e publikuar nuk ka pasqyruar të gjitha modifikimet në kriteret, kërkesa dhe specifikimet teknike të ankimuar nga operatori ekonomik dhe të shqyrtuara nga KPP e konkretisht në pikat:

III.1. Pretendimi i Pikes 1 mbi ndarjen e artikujve me lista sipas drejtorive, Nuk është kryer modifikim i saktë.

III.2. Lidhur me modifikime të Kriterit 2.3.2 **Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë në kriter që operatorët ekonomikë të disponojnë autorizimin e prodhuesit** për pajisjet e kërkuara në numër të madh apo me rëndësi të veçantë. Nuk është zbatuar mbi kërkesë për pajisje në nr. të madh.

III.6.5 Mbi Specifikimet Teknike ka pasaktësi në shtojcë.

II.3. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor Bashkia Shkodër nuk ka zbatuar plotësisht dhe me korrektësi vendimin e KPP-së. Autoriteti Kontraktor duhet të publikojë shtojcën me të gjitha ndryshimet e kërkuara nga ankimesi dhe të pranuar nga KSHA dhe nga KPP, në zbatim të vendimit Nr.320/2026, datë 02.03.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit për procedurën e prokurimit “E Hapur”, me Nr. REF-75576-02-09-2026, me objekt: Blerje paisje të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), me fond limit në vlerën: 10,471,893 Lekë pa TVSH, për t’u zhvilluar me datë 27.02.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkodër.
2. Autoriteti kontraktor të publikojë shtojcën në SPE me të gjitha modifikimet e dokumenteve të procedurës së prokurimit sipërcituar konstatuar më sipër.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

